

## **MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË SHOQËRINË “ALBCONTROL” SHA TIRANË**

Raporti përfundimtar i Auditimit të ushtruar në shoqërinë “Albcontrol” sha Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2015 deri më datë 31.12.2015 dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 21, datë 17.03.2016.

Bazuar në nenet 15, 25 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, me shkresën nr. 1212/6, datë 17.03.2016 i është dërguar shoqërisë “Albcontrol” sha, Tiranë dhe Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe rekomandimet”.

Kontrolli i Lartë i Shtetit ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

### **A. MASA ORGANIZATIVE DHE SHPËRBLIM DËMI**

1. Nga KLSH është ushtruar auditim i mëparshëm në “Albcontrol” SHA, në zbatim të programit të auditimit nr. 108/2, datë 13.02.2015, për periudhën 2013-2014. Në përfundim të auditimit, me shkresën 108/24, datë 03.07.2015, janë dërguar rekomandimet dhe masat e marra për përmirësimin e gjendjes të “Albcontrol” SHA. Nga 24 masa organizative të rekomanduara rezulton se janë realizuar 15 masa dhe 9 masa janë në proces realizimi. Nga 18 masa për Shpërbllim Dëmi të rekomanduara, janë realizuar 16 dhe 2 masa janë në proces realizimi. Në lidhje me rekomandimet për shpenzime jo në përputhje me Parimet e Ekonomicitetit, Efijencës dhe Efektivitetit, 2 rekomandime të lëna janë në proces realizimi. Në lidhje me 19 Masat Disiplinore të rekomanduara, nuk janë realizuar, por nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm këto masa janë në proces shqyrtimi. Nga 2 Masat Administrative të rekomanduara, të 2 masat janë në proces realizimi. *(Trajtuar më hollësisht në faqet 13-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### ***Sa më sipër, është rekomanduar:***

Nga organet drejtuese të shoqërisë të merren masa për realizimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH nga auditimet e mëparshme, të cilat rezultojnë në proces realizimi,

-Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë, të marrin masa për të amenduar kontratën kolektive të punës nr. 146 prot, datë 27.01.2014, në zbatim të Ligjit nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”.

- Këshilli Mbikëqyrës, të analizojë si dhe të evidentojë përgjegjësitë konkrete e të merret vendimi përkatës, për shpenzimin e kryer në procedurën me objekt “Bërje refresh të kontrollorëve për gjuhën angleze” dhe “Shërbim i trajnimit të personelit teknik Anglisht ATSEP, niveli 3”, për vitet 2013-2014, shpenzim i cili ka rënduar padrejtësisht koston e shoqërisë, pasi shoqëria Albcontrol SHA i zotëron vetë kapacitetet teknike dhe ligjore për kryerjen e këtij shërbimi.

- Këshilli Mbikëqyrës, të rishqyrtojë dhe të evidentojë përgjegjësitë e të merret vendimi përkatës, për shpenzimin e kryer me objekt “Blerje, vendosje tabelash me logon e re të tipit City Light”, shpenzim i cili ka rënduar padrejtësisht koston e shoqërisë, për arsye se është kryer pa një analizë të mirëfilltë ekonomike dhe pa përfitim për shoqërinë Albcontrol SHA.

Në lidhje me rekomandimet për shpenzime jo në përputhje me Parimet e Ekonomicitetit, Efijencës dhe Efektivitetit, 2(dy) rekomandime të lëna janë në proces realizimi, si më poshtë: Për shpenzimet të cilat kanë sjellë një efekt negativ financiar në të ardhurat e shoqërisë, duke sjellë një rëndim të kostove, pasi në realizimin e shpenzimeve që shoqëria duhet të kryejë nuk është zbatuar parimi i 3E-ve, Ekonomicitet, Efikasitet dhe Efijencë:

-Të analizohet nga organet drejtuese, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm, që shpenzimi i programuar çdo vit për “Bërje refresh të kontrollorëve për gjuhën angleze” të kryhet nga vetë shoqëria Albcontrol SHA, pasi i zotëron vetë kapacitetet teknike dhe ligjore për kryerjen e këtij shërbimi.

***Në vazhdimësi***

**2.** Për vitin 2015 Këshilli Mbikëqyrës me Vendimin nr. 14, datë 27.10.2015 ka miratuar programin e Auditit të Brendshëm të shoqërisë për vitin 2016 dhe planin strategjik të auditimit për periudhën 2016-2020, por gjatë vitit 2015 nuk ka marrë në shqyrtim në mbledhjet e zhvillura zbatimin e programit të auditimit çdo tremujor, në kundërshtim me Udhëzimin përkatës të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, i ndryshuar, pjesa IV “Kompetencat e këshillit mbikëqyrës”, pika 6. (Trajtuar më hollësisht në faqet 24-25 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Këshilli Mbikëqyrës gjatë veprimtarisë së tij të marrë masa për të kontrolluar zbatimin e programit të Auditit të Brendshëm në zbatim të Udhëzimit nr. 318, datë 08.04.2009 “Për emërimin, funksionimin dhe shpërblimin e Këshillit Mbikëqyrës në shoqëritë anonime shtetërore”, i ndryshuar, pjesa IV “Kompetencat e këshillit mbikëqyrës”, pika 6, duke trajtuar auditime të veçanta që kanë të bëjnë me miradministrimin e fondeve të shoqërisë.

***Vazhdimisht***

**3.** Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar dhënie sponsorizimi për kryerjen e një aktiviteti me vlerë 500,000 lekë, për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregëtisë dhe Sipërmarrjes me Vendimin nr. 21, datë 16.12.2015. Në dokumentacionin që shoqëronte vendimin ishte vetëm kërkesa e ministrisë për përfitimin e vlerës dhe kjo kërkesë nuk shoqërohej me një preventiv paraprak të zërave të shpenzimeve për aktivitetin që do të kryhej. (Trajtuar më hollësisht në faqet 24-25 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Këshilli Mbikëqyrës, për rastet e vendimeve për sponsorizime, të marrë masa që krahas kërkesës së subjektit për sponsorizim të kërkojë një preventiv paraprak të shpenzimeve për kryerjen e aktivitetit për të cilin kërkohet financimi.

***Vazhdimisht***

**4.** Gjatë vitit 2015 investimet u realizuan në vlerën 793,903 mijë lekë më pak ose në masën 69%. Zëri “Ndërtim-Montime” u realizua më pak në vlerën 271,636 mijë lekë ose në masën

44%. Nuk është përfunduar kontrata për punimet për rikonstrukcionin e godinës Administrative. Zëri “Makineri e Pajisje” u realizua më pak në vlerën 98,028 mijë lekë ose në masën 78%. Zëri “Mirëmbajtje e pjesë ndërrimi” u realizua më pak në vlerën 359,886 mijë lekë ose në masën 67%. Ky mosrealizim ka ardhur si rezultat i vazhimit të punës në mirëmbajtjen e sistemeve dhe radarit.

Investimet për vitin 2015 nuk janë realizuar, gjë që tregon se nuk ka pasur një ndjekje të mire dhe të vazhdueshme nga ana e stafit përgjegjës për mbylljen në afat të kontratave të lidhura. Një tjetër arsye e mosrealizimit të programit të investimeve është dhe programimi me shumë rezerva për disa zëra të investimeve, kryesisht në zërin “mirëmbajtje të sistemeve”.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 26-30 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Nga Drejtoria Ekonomike dhe Sektori i Buxhetit e Kostos të merren masa që të programohen sa më realisht fondet për zërin “mirëmbajtje të sistemeve e pjesë ndërrimi”, duke u mbështetur në nevojat dhe në realizimet e viteve të mëparshme. Të aplikohen parimet e Ekonomicitetit, Efiçencës dhe Efektivitetit në lidhje me programimin e fondeve të investimeve. Të ndiqet realizimi i kontratave sipas afateve të përcaktuara.

***Vazhdimisht***

**5.** Aksioneri me shkresën nr. 4581/1, datë 17.06.2014, ka njoftuar shoqërinë për kryerjen e rivlerësimit të aktiveve afatgjata materiale. Shoqëria për kryerjen e këtij shërbimi ka lidhur kontratën për rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale me profesionistët kontabël të autorizuar [REDAKTUAR]. Realizimi i këtij procesi nga ekspertët nuk ka përfunduar duke mos u zbatuar afatet për kryerjen e tij, të përcaktuara në kontratë.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-43, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Organet drejtuese të shoqërisë të kërkojnë respektimin e afateve të kontratës së shërbimit lidhur për rivlerësimin e aktiveve afatgjata materiale duke rritur efektivitetin e përdorimit të fondeve të shoqërisë.

***Menjëherë***

**6.** Nga një analizë e gjëndjes së llogarive të arkëtueshme që kanë kaluar një vit, rezulton se shumica e kompanive debitore janë në gjëndje falimenti ose likuidimi. Shoqëria Albcontrol SHA në disa prej tyre është regjistruar në listën e kreditorëve të procedurave të likuidimit por probabilitetet për mbledhjen e tyre janë të pakta. Në kundërshtim me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, 39, Instrumentat financiarë: Njohja dhe Matja, paragrafi ”Zhvlerësimi dhe mosarkëtueshmëria e aktiveve financiare”, Njësia ekonomike do të vlerësojë në çdo datë të bilancit, nëse ka të dhëna që një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare është i zhvlerësuar. Në qoftë se këto të dhëna ekzistojnë, atëherë njësia ekonomike do të zbatojë paragrafin 63 (për aktivet financiare e mbajtura me koston e amortizuar), paragrafin 66 (për aktivet financiare e mbajtura me kosto) ose paragrafin 67 (për aktivet financiare të vlefshme për shitje) për të përcaktuar shumën e çdo humbjeje nga zhvlerësimi.

Pjesa më e madhe e detyrimeve i përkasin periudhave nga vitet 1998 deri më 2012. Shoqëria duhet të kishte krijuar një provizion për këto llogari të arkëtueshme. Me këto mosveprime janë krijuar efekte financiare duke sjellë mosparaqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të shoqërisë. Kjo mosparaqitje e drejtë ka ndikuar në rezultatin e shoqërisë dhe në vendimarrjen e marrë nga aksioneri. Zbatimi i standarteve ndërkombëtare të kontabilitetit është një kërkesë e kërkuar me urdhërin e ministrit të financave nr. 24 datë 28.02.2011, si dhe është pjesë e standarteve të Eurocontrol-it për pasqyrimin e pasqyrave financiare.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Organet drejtuese të shoqërisë të marrin masat e nevojshme për krijimin dhe miratimin e provizioneve për llogaritë e arkëtueshme për klientët deri më 2012 duke i pasqyruar në rezultatin financiar të periudhës ushtrimore. Shoqëria të krijojë një provizion për këto llogari të arkëtueshme në vlerën 79,870,000 lekë.

Organet drejtuese të shoqërisë të marrin masat e nevojshme që pasqyrat financiare të shoqërisë të paraqisin saktë dhe me besueshmëri situatën financiare në përputhje me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit.

***Brenda datës 31.12.2016***

**7.** Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të prokurimit, për vitin 2015 në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, Autoriteti Kontraktor është mbështetur në studimin e tregut nëpërmjet sigurimit të ofertave për të njohur nivelin aktual, por nuk është dokumentuar nëse nga Autoriteti Kontraktor janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen, duke krahasuar elementet e mësipërm me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-72, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa për të analizuar dhe dokumentuar koston e mallrave që do të prokurohen, për të njohur nivelin aktual të tregut dhe për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin e fondeve publike për zbatimin dhe përmbushjen me përpikmëri të planit të prokurimit të miratuar, me qëllim përdorimin me ekonomikitet, efektivitet dhe efikasitet të burimeve financiare të shoqërisë.

***Vazhdimisht***

**8.** Në të gjitha dosjet e audituara për vitin 2015, u konstatua se bashkëlidhur procesverbaleve të hartuara nga grupet e punës për llogaritjen e fondeve limit, mungojnë shkresat zyrtare drejtuar operatorëve ekonomik për paraqitjen e ofertave. Gjithashtu, ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomikë janë pa numër protokollit hyrës në Albcontrol SHA, veprime këto në kundërshtim me Ligjin për Prokurimin Publik dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe me rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri duhet të protokollohen, kjo ngarkon me përgjegjësi Njësinë e Prokurimit sipas procedurave të prokurimit.

-Marrja në dorëzim e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues të procedurës së prokurimit me objekt “Blerje mobilje për godinën Teknologjike” nuk është bërë në përputhje me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-72 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Drejtoria e Prokurimit të marrë masa që në të ardhmen t'i kushtohet vëmendjen e duhur institucionale procesit të shqyrtimit dhe vlerësimit të dokumentacionit ligjor dhe administrativ të operatorëve ekonomik dhe ofertave të ofertuesve nga komisionet e vlerësimit të ofertave, duke u mbështetur në dokumente zyrtare dhe fletë analiza të lëshuara nga organe kompetente në përputhje me ligjin për prokurimin publik dhe rregulloren e brendshme të Albcontrol SHA. Ky proces ka një rëndësi të veçantë për zbatimin e parimit të ekonomicitetit në shfrytëzimin e fondeve të shoqërisë.

***Vazhdimisht***

**9.** Në disa procedura prokurimi, konkretisht në procedurën e tenderit “Rikonstruksion i godinës administrative të Albcontrol SHA”, “Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit, sigurisë dhe komunikimit, Krijimi i qendrës së IP Telefonisë”, “Blerje mobilje për godinën Teknologjike”, specifikimet teknike nuk janë hartuar plotësisht në përputhje me nenin 23 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi ato nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë marke apo emri të veçantë, patente, vizatimi ose tipi, origjinë specifike, prodhuesi ose sipërmarrje shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët “ose ekuivalente” të përfshihen detyrimisht në këto specifikime. Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar standartet ISO që i shërbejnë kryerjes me cilësi të këtij shërbimi, por nuk ka vendosur standartet ekuivalente të cilat krijojnë hapësirat e nevojshme për pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve të cilët mund të jenë prodhues ose importues që jo domosdoshmërisht i përkasin një shteti të caktuar por që përmbushin kriteret cilësore që i shërbejnë kryerjes me sukses të këtij prokurimi. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , neni 20, 23,dhe në VKM nr.914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 30, pika 2 ku citohet se “çertifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”. Referuar sa më lart u konstatua se në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Autoriteti Kontraktor ka përcaktuar standartet ISO që i shërbejnë kryerjes me cilësi të këtij shërbimi, por nuk ka vendosur standartet ekuivalente të cilat krijojnë hapësirat e nevojshme për pjesëmarrje sa më të madhe të operatorëve.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-72 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që në të ardhmen gjatë programimit dhe realizimit të procedurave të prokurimit për mallra, shërbime dhe punime:

- të hartojë kërkesa për kualifikim, që sigurojnë konkurrencën e nevojshme, si një nga parimet bazë të prokurimit, për të arritur rezultate të dëshirueshme në menaxhimin me efikasitet të përdorimit të fondeve publike dhe uljen e shpenzimeve procedurale;
- nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, trajtimin e barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit;
- sigurimin e integritetit, besimit publik dhe transparencës në procedurat e prokurimit publik.

#### ***Vazhdimisht***

**10.** Në të gjitha dosjet e audituara të procedurave të prokurimit, raportet përmbledhëse të miratuara nga titullari i autoritetit kontraktor, janë pa datë dhe pa numër protokolli, veprime këto në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Rregulloren e Brendshme të Albcontrol, ku përcaktohet se të gjitha shkresat hyrëse në shoqëri duhet të protokollohen.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-72 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

#### ***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Drejtoria e Prokurimit, të marrë masa që gjatë hartimit të Dokumenteve Standarde të Tenderit, t'i kryejë ato në formën e duhur administrative dhe juridike, duke respektuar afatet dhe procedurat e përcaktuara në ligjin për prokurimin publik nr. 9643, datë 20.11.2006, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe nenin 51/2 të rregullores së brendshme të Albcontrol SHA, e miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 13, datë 27.10.2015, duke përcaktuar qartë datat dhe numrat e protokollit në raportet përmbledhëse të procedurave të prokurimit.

#### ***Vazhdimisht***

**11.** Në tenderin “Bërja refresh e supervisor/assesor” dhe konkretisht në kontratën e shpallur së bashku me dokumentet standarde të tenderit (Shtojca 17, neni 9, pika 9.1), nuk parashikohej detyrimi i Autoritetit Kontraktor, për t'i shlyer operatorit fitues paradhënie për zbatimin e kontratës. Ndërsa në kontratën nr. 1252/3prot, datë 09.10.2015, të nënshkruar midis palëve, në nenin 4 përcaktohet se: “Sipërmarrësi do të marrë një pagesë paraprake në masën prej 30% të vlerës totale të kontratës”, duke shkelur kështu barazinë midis operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenet 2, 59 dhe 60.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Përmirësimi i infrastrukturës së rrjetit, sigurisë dhe komunikimit, Krijimi i qendrës së IP Telefonisë”, referuar kontratës me nr. 78/4 prot, datë 13.08.2015, në nenin 6 “Vendndodhja dhe ekzekutimi” dhe nenin 13 “Hyrja në fuqi dhe kohëzgjatja e kontratës”, përcaktohet se afati i ekzekutimit dhe kohëzgjatja e kësaj kontrate do të jetë dy muaj, ndërsa në DST aneksi, termat e referencës, pika 7 përcaktohet se afati i implementimit të projektit është tre muaj nga lidhja e kontratës. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar , neni 20, 23 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik ”

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-72 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Autoriteti Kontraktor, të marrë masa që në të ardhmen të analizojë dhe të përcaktojë në kushtet e kontratës/ dokumentet standarde të tenderit, termat e referencës dhe të mos i ndryshojë ato gjatë lidhjes së kontratave me operatorët ekonomikë, për të siguruar transparencë dhe barazi midis operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

***Vazhdimisht***

**12.** Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi për rekreacionin për stafin ATCO” me Kontratën nr. 365/3, datë 17.04.2015, me vlerë 5,872,900 lekë pa TVSH, sipas pagesës së kryer rezulton se është paguar subjekti fitues [REDAKTUAR] për të gjithë vlerën e ofertuar, sipas të cilës janë programuar për kryerjen e këtij shërbimi 86 çifte full board. Meqenëse ky shërbim rekreativ është kryer në periudha të ndryshme kohore, Albcontrol SHA, ka qenë e detyruar të paguajë në total vlerën e parashikuar të kontratës, 5,872,900 lekë pa TVSH për 86 çifte. Sipas procesverbalit me nr. 365/5 datë 25.06.2015, të mbajtur nga grupi i punës për ndjekjen dhe ekzekutimin e kontratës, nga data 17.04.2015 deri më datën 25.06.2015, kanë kryer pushimin rekreativ 66 çifte. Konstatohet se është paguar shërbimi i rekreacionit jo vetëm për kontrollorët, por edhe për bashkëshortet(ët) e kontrollorëve, të cilët nuk janë punonjës të shoqërisë. Për sa më sipër, vlera 1,111,836 lekë, përbën dëm ekonomik, dhe si e tillë duhet të dëmshpërblehet nga kontrollorët e trafikut ajror të cilët kanë përfituar shërbimin e rekreacionit për bashkëshortët (et) e tyre.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 52-72 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm i shoqërisë, të merren masa që në të ardhmen të analizohen me përgjegjësi shpenzimet e rekreacionit për stafin e kontrollorëve të trafikut ajror, dhe këto shpenzime të programohen vetëm për personelin e Albcontrol SHA dhe jo për familjarët e tyre.

Nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 1,111,836 lekë**, nga kontrollorët e trafikut ajror të cilët kanë përfituar shërbimin e rekreacionit për bashkëshortët (et) e tyre.

***Menjëherë***

**13.** -Në regjistrin e parashikimeve të gjitha blerjet dhe shërbimet me vlera të vogla, për 84 raste janë programuar secila me vlerën 400 mijë lekë ose në total 33,600 mijë lekë pa TVSH. Në regjistrin e realizimit janë kryer blerje dhe shërbime me vlera të vogla në 99 raste duke përfshirë dhe rastet e paparashikuara me vlerë totale 15,864 mijë lekë pa TVSH.

Regjistri i programimit të blerjeve me vlera të vogla, është hartuar duke vendosur për secilën blerje apo shërbim, vlerën maksimale të përcaktuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe Udhëzimin nr. 3 datë 27.01.2015 “Për

procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”, dhe jo sipas realizimeve të një viti më parë dhe nevojave vjetore të shoqërisë.

Siç konstatohet parashikimi bëhet me një vlerë fikse të kufirit të përcaktuar në udhëzim, pa marrë parasysh realizimet e një viti më parë për çdo rast.

-Veprimet me arkë ku kryesisht bëhen pagesa dhe arkëtime për mbylljen e veprimeve me lekë dhe valutë për shpenzimet e udhëtimeve brenda dhe jashtë vendit kryhen me duke përdorur mandatpagesa dhe mandatarkëtime, të cilat plotësohen me dorë, me numër rëndor të njëpasnjëshëm dhe datë të firmosura nga personat përgjegjës. Për këto veprime mandatet e përdorura janë pa numër serial, dokumentacion ky i përcaktuar në legjislacionin tatimor.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 72-73 , të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Drejtoria e Prokurimeve të marrë masa për hartimin e regjistrit e programimit të prokurimeve për blerje dhe kryerje shërbimesh me vlera të vogla, duke u mbështetur në realizimet e një viti më parë dhe sipas nevojave vjetore të shoqërisë. Regjistri i realizimit të blerjeve dhe kryerjes së shërbimeve me vlera të vogla të hartohet çdo 4/mujor dhe të dërgohet në APP.

Nga Drejtoria e financës të merren masat për plotësimin e dokumentacionit të arkës, me blloqe mandatarkëtimesh dhe mandatpagesash me numër serial.

***Vazhdimisht***

**14.** Shoqëria Albcontrol SHA, në kundërshtim me nenin 21 të Ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, nuk ka formalizuar dhe dokumentuar procedura për menaxhimin e riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të institucionit, të përcaktuara gjatë planifikimit afatmesëm dhe afatgjatë.

*(Trajtuar më hollësisht në faqet 73-75, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Organet drejtuese të shoqërisë të hartojnë dhe miratojnë strategjinë e menaxhimit të riskut si dhe të formalizojnë procedurat për menaxhimin e riskut duke zbatuar nenin 21 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, gjithashtu të përcaktojnë me saktësi rolet e çdo strukture për të bërë të mundur funksionimin dhe mundësimin e kontrollit të tyre.

***Menjëherë***

**15.** Shoqëria Albcontrol SHA e ka organizuar mbajtjen e kontabilitetit mbi bazën e parimeve dhe të metodave, të përcaktuara nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” i ndryshuar dhe Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 65, datë 05.05.2008 “Për shpalljen dhe zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të Raportimit Financiar (SNRF) të përkthyer në gjuhën shqipe”. Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me SNRF, bazuar në parimin e kostos historike. Aktivitet afatgjatë materiale të shoqërisë nuk janë mbajtur me vlerën e drejtë, shoqëria nuk ka bërë teste për vlerësimin e gjëndjes aktuale dhe rishikimin e politikave të përdorura për amortizimin e tyre.

(Trajtuar më hollësisht në faqet 33-44, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

***Për sa më sipër, është rekomanduar:***

Organet drejtuese të shoqërisë të marrin masa për testimin dhe vlerësimin e gjendjes aktuale të aktiveve afatgjata, rishikimin e politikave të përdorura për amortizimin e tyre.

*Vazhdimisht*

**B. PËRCJELLJA E REKOMANDIMEVE**

Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për auditimin e kryer në shoqërinë “Albcontrol” Sha, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 1212/1, datë 05.01.2016, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare”, për periudhën e auditimit 01.01.2015-31.12.2015, do ti përcillen edhe Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë.

***Shënim:*** Gjatë trajtimit të çështjeve në Raportin Përfundimtar të Auditimit, janë trajtuar disa të meta dhe mangësi, për të cilat rekomandojmë që organet drejtuese të shoqërisë ti analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë, si dhe të marrin vendime për dhënien e masave disiplinore për personat përgjegjës.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në vendimin Nr. 21, datë 17.03.2016 ngarkohet Departamenti i Auditimit të Investimeve dhe Projekteve me Financime të Huaja si dhe Shoqërive Publike.

***Shënim:*** Auditimi u krye përgjatë periudhës 07.01.2016 deri 08.02.2016, nga grupi i auditimit Jorida Zhegu, Lavdije Fshazi dhe Blerin Shkurti, më tej u shqyrtua nga k/auditues znj. Yllka Pulashi, Drejtori i Departamentit z. Xhaferr Xhoxhaj dhe Drejtori i Departamentit Juridik dhe Kontrollit të Zbatimit të Standardeve z. Ermal Yzeiraj.

**Mbi zbatimin e rekomandimeve:**

Shoqëria “Albcontrol” Sha, ka kthyer përgjigje për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme me shkresë nr. 1212/7, datë 13.04.2016 ku me urdhrin nr. 298/1, datë 01.04.2016 “Për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit” dhe urdhrin nr. 298, datë 01.04.2016 “Për shlyerjen e detyrimit ndaj “Albcontrol” SHA nga titullari i shoqërisë Albcontrol SHA, janë ngarkuar strukturat përkatëse të shoqërisë për marrjen e masave organizative dhe administrative, për zbatimin e rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, sipas shkresës nr. 1212/6, datë 17.03.2016.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**